
Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës Ekonomike + preventivin , sipas Shtojcës 1*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1.*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6(Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument);*
- ç. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7(Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument);*
- d. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8 Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument.*
- dh. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;*
- e. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10(Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument);*
- f. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).*
- g. *Lista e informacionit konfidencial(Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument.*
- gj.*Deklarate për garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, sipas shtojcës 8/1 .*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- **Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)**

Nëse oferta dorëzohet nga një Bashkim Operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Shenim: Nqs oferta dorëzohet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomike, atëherë në respektim dhe zbatim të VKM nr. 914 , date 29.12.2014 “ Per miratimin e rregullave të prokurimit publik “, i ndryshuar, para dorëzimit të ofertes , bashkimi i operatoreve ekonomike duhet të krijohet zyrtarisht , me një marrëveshje të noterizuar, ku të percaktohet përfaqësuesi i grupit, për qindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi.

Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit** (2017, 2018, 2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet , me nënshkrim dhe vule.

2.2.2.Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se cilës duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

2.2.3.Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

(Në rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument)

2.2.4.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018, 2019 dhe keset e maturuara të vitit 2020 e lëshuar nga sejcila prej njesive vendore ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik në territorin e Republikës së Shqipërisë.

(Në rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument)

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetuesinë e informacionit të paraqitur.

Për realizimin me sukses të projektit Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatorëve duhet të vërtetojnë që kapitali i Kompanisë të jetë i njëjtë ose më i lartë se vlera e përlogatitur e kontratës duke u llogatitur nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Për sa i përket aftësive teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtëme minimale:

- Dëshmi që vërteton se ka realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së kontratës që po prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, të aktivitetit të OE duke llogaritur nga data e zhvillimit të tenderit,

Ose

-Dëshmi që vërteton se ka realizuar punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së kontratës që po prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- a- Për Kontrata për punë publike të realizuara me Subjekte Shtetërore, AK kërkon:
- kopje e kontratës së nënshkruar me autoritetin kontraktor për objektin e realizuar.
 - situcionin përfundimtar të objektit.
 - fatura tatimore për situacioni përfundimtar (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë).
 - akt kolaudimi përfundimtar i objektit
 - Vërtetim i lëshuar nga enti publik ku të shënohet vlera, koha dhe natyra e punës së bërë (që konsiston në formularin e vlerësimit konform Shtojcës 9).

- b- Për Kontrata për punë publike të realizuara me Subjekte Private AK kërkon:

- kontrata e nënshkruar për objektin e realizuar
- situacionin përfundimtar të objektit
- faturat tatimore për situacioni përfundimtar (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë).
- akt kolaudimi përfundimtar
- vërtetim ku të shënohet vlera, koha dhe natyra e punës së bërë (që konsiston në formularin e vlerësimit konform Shtojcës 9, të nënshkruar & vulosur rregullisht nga investitori).
- situacioni përfundimtar (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh pika a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjereë të bashkimit do të paraqesin kontara të ngjashmenë raport me përqindjen e pjesëmarrjes qe kryejnë në bashkim. Pika b) duhet të plotësohet nga të gjithë anëtareët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim.

2.3.2 Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë licenca profesionale të shoqërisë të lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës në kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHËSHME NDËRTIMI:

- *NP-2/B Nderime civile dhe industriale*
- *NP- 3/B Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.*
- *NP-12/B Punime te inxhinierise se mjedisit*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- *NS- 1/B Punime për prishjen e ndërtimeve.*
- *NS- 2/B Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxteri, mirëmbajtja e tyre.*
- *NS-4/B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.*
- *NS-8/B Nderime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri*

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, konform legjislacionit shqiptar në fuqi).

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij teknik për të gjithë periudhën e zbatimit të objektit minimalisht:

2.3.3.a) Stafin teknik duhet të figurojnë në **Licencën e shoqërisë** si drejtues teknik, si më poshtë:

- 1 (një) Ing. Ndërtimi, me të paktën 10 vite eksperiencë në zbatim për objekte të ngjashme.
- 1 (një) Ing. Elektrik, me të paktën 10 vite eksperiencë në zbatim për objekte të ngjashme i certifikuar dhe për auditim energjie
- 1 (një) Ing. Mekanik me të paktën 10 vite eksperiencë në projektim dhe zbatim për objekte të ngjashme.
- 1 (një) Arkitekt me të paktën 10 vite eksperiencë në projektim dhe zbatim për objekte të ngjashme.
- 1 (një) Ing. Hidroteknik me të paktën 10 vite eksperiencë në projektim dhe zbatim për objekte të ngjashme.
- 1 (një) Ing. Mjedisi me të paktën 10 vite eksperiencë në projektim dhe zbatim për objekte të ngjashme i pajisur me Çertifikate të Vleresimit të Ndikimit të Mjedisit.

Për të vërtetuar këtë për secilin prej tyre duhet të paraqiten:

- Kontratat e vlefshme të punës mes palëve
- CV-të
- Diplomat
- Librezë pune

Ky staf të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2019 - Korrik 2020.

2.3.3. b) **Stafin teknik mbështetës**

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë gjithashtu, stafin teknik mbështetës punonjës të certifikuar si

- i. **Ekspert të mbrojtjes kundër zjarrit**, për të cilin të paraqitet certifikata nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të paraqitet kontrata e punës, diploma, CV dhe të figurojë në listëpagesat të shoqërisë .
- ii. **2 Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist (minimumi i nivelit të Diplomimit master)** , për të cilin të paraqitet diploma, kontrata e punës, CV dhe të figurojë në listëpagesat të shoqërisë.

2.3.4 Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se zotëron fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: të vërtetojë se ka të siguruar **mesatarisht 126 punonjës** (përfshirë stafin drejtues teknik) për periudhën Gusht 2019 – Korrik 2020. Për këtë të paraqesë deklaratat e listëpagesave nga Drejtoria Tatimore, sipas formularit E-SIG 025/a, të nënshkruara elektronikisht ose në hard copy.

2.3.5 *Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë në anë të një deklaratë nga Administratori i shoqërisë së drejtuesi teknik i punimeve do të angazhohet në objekt sipas grafikut të punimeve.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 50 punonjës të certifikuar me dëshmi të sigurimit teknik lëshuar nga DPA ose Trupa certifikuese ekuivalente, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv. Brenda kësaj liste duhet të deshmohet, dhe të figurojë në listepagesa për 12 muajt e fundit:

- 1 Elektricitist vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 1 Hidraulik vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 3 Teknik ndërtimi vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë /dëshmi /diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 8 Manovratorë të mjeteve të rënda, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme.
- 1 punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- 1 punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e vetë Mjekë të Përgjithshëm, për vërtëtimin e këtij kriteri duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Kontratë pune individuale, Licencë, Diplomë dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2019-Korrik 2020*

Ne rast të ofertimit nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik, të gjithë anetarët e BOE duhet të plotësojnë këto kërkesë.

2.3.8 Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 3</i>
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 5-10 ton	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
3.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 2-3 ton	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
4	Kamionçinë (deri në 3.5 ton)	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Kamion me vinc</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Gjenerator</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 4</i>
7	<i>Depozita uji me kapacitet total 5000 litra</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
8	<i>Vibrator</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
9	<i>Skela metalike për punime të brendëshme dhe te jashteme</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>1500 m 2</i>
10	<i>Rrjetë mbulimi për skelat</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>1500 m2</i>
11	<i>Autobot uji</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 2</i>
12	<i>AutoBetoniere</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Pompe betoni</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Cope 1</i>
14	<i>Eskavator me goma kove para kove prapa</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 1</i>
15	<i>Pirun</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 1</i>
16	<i>Matrapik</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Copë 3</i>
17	<i>Betoniere 0.25 m3</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Cope 4</i>
18	<i>Saldatrice/motosaldatrice</i>	<i>pronësi ose qira</i>	<i>Cope 2</i>

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, dhe foto e tij.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes /cdoganimi, fotot dhe fatura tatimore përkatëse.

Kur mjetet / pajisjet teknike jane me qira, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirasë (për gjithë periudhën e objektit të prokurimit) dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar më sipër, sipas përkatësisë.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Per secilin nga mjetet e kerkuara me siper te paraqitet foto, akt pronesie origjinal ose fotokopje e noterizuar.

2.3.9 *Operatori ekonomik duhet të disponojë mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punetoreve, personelit si më poshtë:*

1. *Helmeta mbrojtëse për kantier 30 cope*
2. *Fikese zjarri të levizshme – 3 cope*
3. *Komplet pajisjes të ndihmes së shpejte 4 cope*
4. *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt 10 cope*
5. *Kulle ndriçimi* *1 Komplet/Set*

Për vërtetimin e disponimit të këtyre mjeteve dhe pajisjeve në punë të paraqiten faturat tatimore të blerjes ose cdo dokumentacion tjetër që provon disponimin e tyre.

2.3.10 *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) për sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- ISO 14001 - 2015 ose ekuivalente (e vlefshme) për sistemin e menaxhimit të mjedisit
- OHSAS 45001:2018 ose ekuivalente (e vlefshme) për sistemin e menaxhimit Shëndetësor dhe të Sigurisë në punë.
- PAS 99-2012 ose ekuivalente (e vlefshme) për sistemin e integruar i sistemeve të menaxhimit të shoqërisë, mjedisit dhe sigurisë në punë
- ISO 50001:2018 ose ekuivalente (Sistemi i menaxhimit të energjisë)
- ISO 39001:2012 ose ekuivalente (Certifikate për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor)
- ISO 27001:2013 ose ekuivalente (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit);
- SA 8000:2014 ose ekuivalente (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore);

*- Operatori, duhet të disponojë dhe të paraqesë **licencë me kod III 2. B** lëshuar nga QKL për veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.*

*- Operatori, duhet të disponojë dhe të paraqesë **licencë me kod III 2. A** lëshuar nga QKL për veprimtari të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.*

*- Operatori, duhet të disponojë dhe të paraqesë **licencë me kod I 2. A** lëshuar nga QKL për veprimtari të Ekspertizës të MNZ.*

2.3.11. Analizat e cmimeve për cdo zë të preventivit **mosparaqitja e tyre përben shkak për skualifikim** .

2.3.12. Cdo ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga administratori. Në rast **BO grafikun e punimeve** duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve përkatës.

- Operatoret e huaj ekonomike, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës

Dokumenta Standarde të Tenderit

për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

-Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen nenit 74 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014, e ndryshuar.

-Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 23 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalent”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si

rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

- 16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

